



EASO - Raporti rreth Azilit, 2021

Raporti Vjetor rreth
situatës së azilit në
Bashkimin Evropian

**PËRMBLEDHJE E
PËRGJITHSHME**





Imazhi i kopertinës: Steve Evans

© Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin, 2021

Riprodhimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat të drejtat e autorit nuk i ka EASO, duhet të kërkohet leje direkt nga zotëruesi i të drejtave të autorit.

PDF ISBN 978-92-9465-060-3 ISSN 2600-3139 DOI 10.2847/91077 BZ-AH-21-001-SQ-N



EASO - Raporti rreth Azilit, 2021

Raporti Vjetor rreth situatës së azilit në Bashkimin Evropian

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

PËRKRAHJA ËSHTË MISIONI YNË

Parathënie

Këtë vit realizohet botimi i 10-të i edicionit kryesor të agjencisë, *Raporti EASO rreth Azilit*. Raporti është përmirësuar vazhdimisht gjatë viteve për të kapur dhe raportuar tendencat e fundit, si edhe diskutimet e politikave të fokusuara në ndërtimin e harmonizuar të një Sistemi të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Jemi krenarë që *Raporti EASO rreth Azilit* ka evoluar në një burim prestigjioz informacioni mbi azilin në Evropë dhe pasqyron rritjen e agjencisë si një qendër ekspertize për çështje të azilit që nga themelimi i saj më 19 qershor 2010.

Në të vërtetë, roli rritës i EASO-së theksohet në [Paktin e ri për Migracionin dhe Azilin](#) të Komisionit Evropian, i cili është botuar në shtator 2020. Pakti ofron një fillim të freskët për diskutimin mbi menaxhimin efektiv dhe njerëzor të migracionit dhe azilit në Evropë. EASO është e gatshme të ndërmarrë një mandat të zgjeruar si Agjencia e BE-së për çështjet e Azilit (EUAA) dhe të shërbejë si pjesë integrale e kornizës evropiane për të menaxhuar realitetin kompleks të migracionit, duke respektuar plotësisht të drejtat themelore.

Pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të rëndësishëm në çdo aspekt të jetës në tërë botën. Me qëllim për të kufizuar përhapjen e virusit dhe për të mbajtur njerëzit të sigurt, duke përfshirë ata që kërkojnë strehim në Evropë si edhe personelin që punon drejtpërdrejt me azilkërkuesit, masa emergjente dhe ndryshime afatgjata në procedura, janë zbatuar në të gjitha vendet e BE+. Këtë vit, Shtetet Anëtare, autoritetet kombëtare të azilit dhe pritjes dhe organizatat që punojnë në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare janë përballuar për herë të parë nga themelimi i CEAS me një sfidë të dyfishtë: të respektohet e drejta themelore e njeriut për të jetuar në siguri dhe të menaxhohet një krizë shëndetësore globale, e cila mund t'i ekspozojë si migrantët ashtu edhe vendet pritëse ndaj rreziqeve të mëtejshme.




Ndërsa administratat kombëtare janë testuar deri në kufijtë e mundësive, aktivitetet e EASO-s kishin për qëllim drejtpërdrejt mbështetjen e Shteteve Anëtare për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve dhe për të ofruar ndihmë emergjente. Gjatë vitit 2020, agjencia ka zhvilluar mjete për të përmirësuar dhe përafruar procedurat, për të botuar raporte analitike dhe për të trajnuar profesionistë në fushën e azilit. Një iniciativë e përkushtuar për mbledhjen e informacionit ka siguruar informacion të azhurnuar, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm mbi ndikimin e COVID-19 në procedurën e azilit. Rezultatet tregojnë qëndrueshmërinë e sistemeve kombëtare të azilit dhe pritjes së BE-së, të cilat kanë adaptuar shpejt modalitetet e punës dhe janë kthyer në zgjidhje dixhitale për t'u ofruar strehim atyre që kanë nevojë. Këto risi mund të jenë çelësi për të rritur efikasitetin dhe për të adresuar sfida të ngjashme në të ardhmen, duke ruajtur një sistem evropian të qëndrueshëm.

Nina Gregori
Drejtore Ekzekutive
Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin

Hyrje

Si burim kryesor i informacionit për mbrojtjen ndërkombëtare në Evropë, *Raportet EASO rreth Azilit* ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve kryesore lidhur me çështjet e azilit në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, Islandë, Lihtenshtajn, Norvegji dhe Zvicër (vendet e BE+). Duke filluar me një shqyrtim të shkurtër të problemeve të zhvendosjes së detyruar në nivel global, raporti ngushton kontekstin në Evropë dhe përmbledh ndryshimet hap pas hapi nëpër të gjitha aspektet e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Raporti paraqet praktikën ligjore të zgjedhur, e cila ka formësuar interpretimin e ligjeve evropiane dhe kombëtare, si edhe treguesit statistikorë kryesorë për vitin e referencës 2020, të cilët theksojnë trendet e tanishme dhe efektivitetin e sistemeve të azilit.



Pasqyra globale e azilit në 2020



Miliona njerëz në tërë botën janë viktime të zhvendosjes së detyruar për shkak të konflikteve, persekutimit, shkeljeve të të drejtave të njeriut, katastrofave natyrore dhe degradimit të ekosistemeve.

Statistikat zyrtare dallojnë midis dy grupeve personash të zhvendosur me forcë:

a) refugjatët dhe azilkërkuesit që kanë kaluar kufijtë ndërkombëtarë; dhe b) personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) të cilët janë zhvendosur brenda vendit të vet. Refugjatët janë persona që janë larguar nga vendi i vet për shkak të frikës së arsyetuar që do të përndiqen për arsye race, feje, kombësie, anëtarësimi në një grup të caktuar shoqëror ose mendimi politik dhe kanë kaluar një kufi ndërkombëtar, duke kërkuar siguri. Personat e zhvendosur brenda vendit nuk e kanë kaluar kufirin e vendit të tyre, por sërish mund të gjenden në një situatë delikate.

Në kontekstin e Evropës, mbrojtja ndërkombëtare përfshin statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes së përkohshme. Kjo e fundit u referohet personave të cilët nuk kualifikohen për statusin e refugjatit, por kanë të drejtën e mbrojtjes për shkak se rrezikohen nga dëmtimi i rëndë, ku përfshihet dënimi me vdekje ose ekzekutimi; tortura ose trajtimi a ndëshkimi çnjerëzor ose poshtërues në vendin e origjinës; ose kërcënim i rëndë dhe individual për jetën për shkak të dhunës së verbër në situatat e konfliktit të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

Në qershor 2020, Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) ka raportuar një popullsi totale të prekur prej afërsisht 80 milionë njerëz, duke përfshirë 26,4 milionë refugjatë, 4,2 milionë azilkërkues, 45,7 milionë PZHBV dhe 3,6 milionë venezuelas të zhvendosur jashtë vendit.

Dy të tretat e popullsisë globale të refugjatëve vijnë nga pesë vende të origjinës: Siria, Venezuela, Afganistani, Sudani i Jugut dhe Birmania (sipas rendit zbritës). Shumica dërmuese e popullsisë së zhvendosur strehohet në vendet dhe komunitetet fqinje të qendrës së krizës, të cilat janë shpesh vende në zhvillim. Në vitin 2020, Turqia ka vazhduar të jetë vendi pritës kryesor, i pasuar nga Kolumbia, Pakistani, Uganda dhe Gjermania.

Pandemia COVID-19 e cila ka goditur në vitin 2020 ka pasur një ndikim të thellë dhe kompleks, si në krijimin ose zmadhimin e nevojave të mbrojtjes në tërë botën ashtu edhe në pengimin e qasjes në siguri. Në këtë kontekst sfidues, palët e interesuara të përfshira në sigurimin e mbrojtjes e kanë përshtatur punën e vet në pajtim me rrethanat, me qëllim për të siguruar vazhdimësi në shërbime, duke përfshirë modalitete të reja për regjistrimin dhe përpunimin e aplikacioneve dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë dhe zgjidhjeve dixhitale.

Me gjithë sfidat e pandemisë, komuniteti ndërkombëtar ka punuar nëpërmjet bashkëpunimeve shumëpalëshe. Arritjet e vitit 2020 në kuadër të Kompaktit Global për Refugjatët përfshijnë:

- ➔ Rritja e kapacitetit të mbrojtjes në tërë botën;
- ➔ Rritja e qasjes në arsim për fëmijët e zhvendosur;
- ➔ Promovimi i zgjidhjeve të qëndrueshme;
- ➔ Implementimi i zgjidhjeve për energjinë e pastër në mjediset humanitare;
- ➔ Nxitja e zhvillimit njerëzor dhe rritjes ekonomike si zgjidhje strukturore në mjedise të brishta;
- ➔ Rritja e qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore, ujin e pastër e kanalizimin; dhe
- ➔ Promovimi i mundësive të punësimit për personat e prekur nga zhvendosja.

BE luan një rol kryesor në sigurimin e zgjidhjeve mbrojtëse në nivel botëror, duke alokuar pjesën më të madhe të buxhetit të saj humanitar për projekte që kanë për qëllim t'i ndihmojnë njerëzit e zhvendosur me forcë dhe komunitetet e tyre pritëse.

Ndërsa bashkësia ndërkombëtare vazhdon përpjekjet e saj për të adresuar aspekte komplekse të zhvendosjes në plan global, fokusi i zhvillimit mund të ndryshojë nga viti në vit në zonat e synuara, ku mund të përparohet për të lehtësuar situatat e zhvendosjes ose ku mund të zhvillohen modalitete të reja për të siguruar mbrojtje. Në vitin 2020, diskutimet fokusoheshin në dy zona lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare, secila për arsye të ndryshme. **Rivendosja** ishte ndër zonat që janë ndikuar fuqimisht nga pandemia për shkak të kufizimeve të udhëtimit. Me rreziqet lidhur me lëvizjen gjatë urgjencës shëndetësore globale, nevoja për të ofruar një rrugë ligjore të sigurt të rivendosjes është bërë edhe më e theksuar. Në të njëjtën kohë, pandemia u ka dhënë mundësinë shteteve për të bërë përparime të mëtijshme në fushën e **dixhitalizimit**, me qëllim për të rritur efikasitetin në procedurat e azilit.



Modelet globale në nevojat e mbrojtjes ndërkombëtare, 2020

5 shtete
përfaqësojnë
2/3 të
popullsisë
globale të

6,6 milionë
Siria

3,6 milionë
Venezuela

2,7 milionë
Afganistani

2,3 milionë
Sudani i Jugut

1,0 milion
Mjanmari

Refugjatët venezuelas
kanë qenë grupi më i
madh i azilkërkuesve të
rinj në vitin 2020

Turqia ka pranuar numrin më të
madh të refugjatëve, pasuar nga
Kolumbia, Pakistani, Uganda dhe
Gjermania.

85% e popullsisë
globale të refugjatëve
është pranuar nga vende
në zhvillim



Pandemia Covid-19 ka pasur një
ndikim kompleks në krijimin ose
zmadhimin e nevojave të mbrojtjes
në tërë botën, si edhe në pengimin e
qasje në siguri.



Programet e rivendosjes
janë pothuajse ndalur për shkak të
kufizimeve të udhëtimit gjatë
pandemisë COVID-19



Pandemia u ka dhënë mundësi
shteteve për të bërë përparime
të mëtijshme në fushën e
dixhitalizimit, me qëllim
për të rritur efikasitetin në
procedurën e azilit

Burimet: EASO dhe të dhëna nga UNHCR



2. Zhvillimet kryesore në fushën e azilit në Bashkimin Evropian në 2020



Në bazë të progresit të bërë në negociatat mbi dy paketa propozimesh për reformën nga viti 2016, në shtator 2020 Komisioni Evropian ka paraqitur **Paktin e ri për Migracionin dhe Azilin**. Ai propozon një fillim të freskët për trajtimin e migracionit, nëpërmjet procedurave të përmirësuara, më të shpejta dhe më efektive, duke vendosur ekuilibrin e nevojshëm midis ndarjes së drejtë të përgjegjësisë dhe solidaritetit. Pakti për Migracionin dhe Azilin synon të përcaktojë kornizën për:

- Menaxhimin e fortë dhe të drejtë të kufijve të jashtëm, duke përfshirë identitetin, shëndetin dhe kontrollet e sigurisë;
- Sisteme të drejta dhe efikase të azilit në të gjitha vendet e BE+, duke përfshirë riorganizimin e procedurave dhe kthimin e aplikantëve të refuzuar;
- Një mekanizëm të ri solidariteti për zbarkimet pas operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit për vendet nën presion të shtuar dhe situatat e krizës;
- Parashikimi të fortë, gatishmëri dhe reagim ndaj krizave;
- Një politikë të efektshme kthimi dhe një qasje të koordinuar në nivel të BE-së për kthimin e shtetasve të vendeve të treta në vendin e origjinës;
- Qeverisjen gjithëpërfshirëse në nivel të BE-së për të menaxhuar dhe zbatuar më mirë politikat e azilit dhe migracionit;
- Partneritete reciproke të dobishme me vendet e treta kryesore të origjinës dhe tranzitit;
- Rrugë të qëndrueshme ligjore për ata që kanë nevojë për mbrojtje dhe tërheqjen e talentëve ndaj BE-së; dhe
- Politika efektive të integritetit.


Për të arritur këto qëllime, Komisioni Evropian ka mbajtur propozimet e veta dhe ka mbështetur marrëveshjet e përkohshme të arritura tashmë mbi Rregulloren e Kualifikimit, Direktivën e Kushteve të Pritjes, Rregulloren Kornizë të Bashkimit për Çështjet e Rivendosjes dhe Agjencinë e BE-së për Çështje Azili. Gjithashtu, ai ka bërë një thirrje për përfundimin e shpejtë të negociatave mbi Direktivën e rishikuar të Kthimit. Komisioni Evropian ka tërhequr propozimin e vitit 2016 për ndryshimin e Rregullores së Dublinit dhe e ka zëvendësuar me një propozim të ri lidhur me një Rregullore për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit. Në kombinim me pesë propozimet nga vitet 2016 dhe 2018 të cilat janë miratuar, pakti përfshin një paketë prej nëntë instrumentesh shtesë:

- ➡ Një rregullore e re e shqyrtimit
- ➡ Një propozim i modifikuar për të rishikuar Rregulloren e Procedurës së Azilit
- ➡ Një propozim i modifikuar për të rishikuar rregulloren Eurodac
- ➡ Një rregullore e re për menaxhimin e azilit dhe migracionit
- ➡ Një rregullore e re për krizat dhe situatat e forcës madhore
- ➡ Një Plan i Ri i Gatishmërisë dhe Menaxhimit të Krize të Shkaktuara nga Migracioni
- ➡ Një rekomandim i ri lidhur me çështjet e rivendosjes dhe rrugë plotësuese

- Një rekomandim i ri lidhur me operacionet e kërkimit dhe shpëtimit nga ana e anijeve private
- Një udhëzim i ri lidhur me Direktivën për Lehtësuesit.

Prezantimi i Paktit për Migracionin dhe Azilin dhe propozimet për instrumentet ligjore shoqëruese kanë nxitur diskutime të reja për një menaxhim efektiv dhe njerëzor të migracionit në Evropë. Qasja holistike e Komisionit Evropian në koordinimin e një procesi inkluziv konsultimi dhe përpjekja për të integruar plotësisht lidhjet midis fushave të ndryshme të politikës së migracionit dhe azilit në një qasje koherente janë vlerësuar pozitivisht, po ashtu si edhe përpjekja e mirëfilltë për të akomoduar nevojat e ndryshme të shteteve anëtare të BE-së dhe për të zgjidhur polemikat e së kaluarës. Ndërsa pikëpamjet e ndryshme lidhur me aspekte të caktuara të politikës së propozuar të migracionit dhe azilit vazhdojnë midis Shteteve Anëtare, propozimet e paraqitura nga Komisioni Evropian sigurojnë bazën për një dialog konstruktiv të mëtejshëm në nivel teknik dhe politik gjatë procesit legjislativ. Ndër reagimet pozitive ka pasur gjithashtu zëra nga aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, të cilat kanë tërhequr vëmendjen tek ato fusha ku mund të bëhet më shumë.

Natyrisht, pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të thellë si në rrjedhat e migrimit ashtu edhe në funksionimin e sistemeve të azilit në Evropë. Duke pranuar plotësisht vështirësitë, me të cilat përballen Shtetet Anëtare në zbatimin e rregullave përkatëse të BE-së gjatë pandemisë, Komisioni Evropian ka lëshuar një **komunikatë**, me qëllim për të ofruar udhëzime lidhur sigurimin e vazhdimësisë së procedurave të azilit dhe kthimit, si edhe të rivendosjes. Vendet e BE+ kanë implementuar një numër masash nëpër hapat e ndryshëm të procedurës së azilit, duke përfshirë ambientet e pritjes, për të mbrojtur mirëqenien fizike të individëve. Masat kufizuese, të justifikueshme për arsye të shëndetit publik, kanë pasur ndoshta një ndikim, megjithëse të përkohshëm, në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, duke marrë parasysh se palët e interesuara kanë theksuar që masat duhet të jenë të përkohshme dhe proporcionale dhe të zbatohen vetëm në rast të nevojës.



Burim: EASO

Në një përpjekje për të vazhduar me ofrimin e shërbimeve, duke respektuar njëkohësisht masat e reja, vendet e BE+ kanë dixhitalizuar shumë hapa të procedurës së azilit, duke zhvilluar dhe zbatuar sisteme elektronike të reja. Shumë prej këtyre zgjidhjeve mund të qëndrojnë në mënyrë të përhershme me qëllim për të rritur efikasitetin e sistemeve të azilit, ndërsa të tjerat mund të përdoren si projekte metodologjike në rast se vendet e BE+ do të përballen me sfida të ngjashme në të ardhmen.

Me gjithë uljen e përgjithshme në numrin e mbërritjeve në kufijtë e jashtëm të BE-së gjatë vitit 2020, u shfaqën tendenca të ndryshme në itineraret e migracionit drejt BE-së. Itineraret e Mesdheut Perëndimor dhe Lindor kishin më pak mbërritje krahasuar me vitin 2019, ndërsa itineraret e Afrikës Perëndimore, Mesdheut Qendror dhe Ballkanit Perëndimor patën rritje të mbërritjeve. Kufijtë dhe ishujt grekë vazhdojnë të jenë nën presion të konsiderueshëm dhe Komisioni Evropian ka bashkëpunuar si me autoritetet greke ashtu edhe me shtetet e tjera anëtare të BE-së për të siguruar mbështetje kritike për zgjidhjen e situatës, duke përfshirë një ushtrim të zhvendosjes vullnetare nga Greqia në vendet e tjera anëtare për fëmijë të pashoqëruar dhe fëmijë me cënueshmëri në familje.

Rivendosjet kanë vazhduar gjithashtu pas misionëve të kërkimit dhe shpëtimit në Detin Mesdhe. Zbarkimet dhe rivendosjet janë koordinuar nga Komisioni Evropian dhe janë mbajtur me pjesëmarrjen e agjencive përkatëse të BE-së, përfshirë EASO, në pajtim me procedurat standarde të funksionimit të zhvilluara në 2019. Këto përpjekje e kanë demonstruar solidaritetin evropian në praktikë, por kanë nënvizuar gjithashtu nevojën për një mekanizëm solidariteti më të parashikueshëm për zbarkimin dhe rivendosjen, ashtu siç parashikohet në rregulloren e re të propozuar për rregullimin e azilit dhe migracionit.


Fundi i vitit 2020 ka sinjalizuar gjithashtu fundin e periudhës së tranzicionit gjatë së cilës ligjet e BE-së zbatohen në dhe brenda Mbretërisë së Bashkuar, pas tërheqjes së saj nga BE-ja. Që nga 1 janari 2021, ligji përkatës i BE-së lidhur me çështjet e azilit nuk zbatohet më automatikisht, përveç rastit kur ai është ruajtur në sistemin ligjor të brendshëm. Një gjë shumë e rëndësishme është që Rregullorja Dublin III është shfuqizuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe dispozitat e saj kanë pushuar së zbatuari.

Gjatë vitit 2020, BE-ja ka vazhduar bashkëpunimin e vet me partnerët e jashtëm për të menaxhuar presionin e migracionit nëpërmjet një përqasjeje gjithëpërfshirëse të themeluar në multilateralizëm. Qëllimet e aktiviteteve të implementuara nën dimensionin e jashtëm të politikës së migracionit të BE-së përfshijnë adresimin e shkaqeve rrënjësore të migracionit; luftën kundër kontrabandës; përmirësimin e bashkëpunimit me vendet e treta lidhur me kthimin dhe ripranimin; bashkëpunimin me vendet partnere në menaxhimin e kufirit dhe mbështetjen për të siguruar mbrojtje jashtë vendit.

Në rolin e vet për të siguruar interpretimin dhe aplikimin e harmonizuar të ligjit të BE-së, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) dha disa gjykime kryesisht në lidhje me vendimet paraprake, duke interpretuar më tej disa dispozita të CEAS-it. Temat ligjore përfshijnë qasjen efektive, procedurën e azilit, sigurimin e intervistave personale në raste të papranueshme, format e mbrojtjes, paraburgimin, procedurat e shkallës së dytë, mosdiskriminimin midis shtetasve dhe përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare që kanë fituar shtetësinë më pas, ribashkimin e familjes dhe ruajtjen e unitetit familjar, kthimin e shtetasve të vendeve të treta, rivendosjet, mbrojtjen e ofruar për palestinezët pa shtetësi nga ana UNRWA-së dhe refuzimin për të kryer shërbimin ushtarak. Për më tepër, Gjykata e Drejtësisë së BE-së ka lëshuar një aktgjykim mbi kufizimet kombëtare për financimin e OJQ-ve, duke prekur OJQ-të që punojnë në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare.



Evolucioni i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS)



3. Mbështetja e EASO-së për vendet



Në vitin 2020 festohet përvjetori i 10-të i themelimit të EASO-së. Në pajtim me rregulloren e saj themeluese, EASO fokusohet në përmirësimin e zbatimit të CEAS, përforcimin e bashkëpunimit praktik në çështje azili midis Shteteve Anëtare dhe sigurimin e mbështetjes operative për Shtetet Anëtare që përjetojnë një presion të veçantë në sistemin e tyre të azilit dhe pritjes.

Në kontekstin e pandemisë COVID-19, aktivitetet e EASO-së në vitin 2020 kanë synuar në mënyrë të drejtpërdrejtë t'u ndihmojnë Shteteve Anëtare në mënyrë që ato të sigurojnë vazhdimësinë e operacioneve, duke organizuar vazhdimisht aktivitete trajnuese dhe duke lehtësuar takimet në internet midis Shteteve Anëtare. EASO ka nisur një iniciativë të dedikuar për mbledhjen e informacionit, e cila ka pasur për qëllim t'u ofrohet palëve kryesore të interesit informacion të azhurnuar, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm mbi ndikimin e pandemisë COVID-19 në sistemet kombëtare të azilit dhe pritjes, si edhe në planet e vaksinimit për azilkërkues dhe përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare. Për të siguruar standarde të larta në përpunimin e aplikimeve të azilit gjatë pandemisë, EASO ka lëshuar rekomandime praktike për kryerjen e intervistave personale dhe regjistrimeve në distancë/në internet.

Lidhur me punën operacionale të EASO-së, masat shëndetësore kanë nxitur fokusimin për t'u zhvendosur rrjedhat e punës në zyrë, duke përfshirë ndjekjen e dosjeve; detyrat administrative të regjistrimit; sigurimin e mbështetjes për paraqiten e ankesave; aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve; përmirësimin e politikave dhe procedurave; dhe mbështetjen për marrje dhe dhënien e informacionit në distancë përmes linjave të ndihmës. EASO qenë aktiv gjithashtu në terren dhe ka ndihmuar në rivendosjen e fëmijëve të pashoqëruar nga Greqia në Shtetet Anëtare të tjera. Mbështetja për Spanjën është dakorduar gjithashtu në fund të vitit 2020 me qëllim për të lehtësuar presionin në sistemin e saj të pritjes dhe për të zhvilluar një model të ri pritjeje.



Video: Ngjarjet kryesore dhe arritjet e EASO-së



Burimi: EASO

4. Funksionimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit

Zhvillimet kryesore në nivel kombëtar në vitin 2020 kanë formësuar legjislacionin, politikat dhe praktikën në fushën e azilit në vendet e BE+. Të dyja temat horizontale në secilin hap të procedurës së azilit ishin ndikimi i pandemisë COVID-19 dhe dixhitalizimi i procedurave të azilit.




Dixhitalizimi i procedurës së azilit



Kufizimet e lëvizjes dhe distancimi shoqëror kanë siguruar shtysën e nevojshme për vendet që të përdoren mjete dixhitale dhe t'i përshtatin praktikën në qendrat e pritjes



Pavarësisht nga përfitimet, dixhitalizimi mund të sjellë rrezeqe të mundshme që lidhen me mbrojtjen e të dhënave, shkrim-leximin dixhital dhe lidhshmërinë



Burimi: EASO





COVID-19

Kufizimet e udhëtimit gjatë pandemisë COVID-19 kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në mundësitë e azilkërkesve për të arritur territorin e BE-së. Autoritetet kombëtare janë detyruar të përshtaten shpejt me rrethanat e reja duke pezulluar ose kufizuar regjistrimet për një periudhë të shkurtër gjatë valës së parë të pandemisë. Gjatë kësaj kohe, vendet e BE+ kanë riorganizuar proceset dhe mjedisin e punës.

Më pak azilkërkes janë kanalizuar në procedurën e Dublinit, ndërsa procesi i transferimeve duhej adaptuar për t'iu përmbajtur kërkesave shëndetësore të rrepta. Teoria juridike e vitit 2020 sugjeron që presioni mbi sistemet shëndetësore është bërë një faktor shtesë që duhet marrë parasysh kur përcaktohet cili është shteti anëtar përgjegjës për një aplikim azili.

Distancimi fizik, mbyllja e ambienteve, puna në distancë dhe protokollet shëndetësore kanë ndikuar në të gjithë hapat e përfshirë në përpunimin e aplikacioneve si në shkallën e parë ashtu edhe në të dytën, duke përfshirë intervistat personale, sigurimin e interpretimit, njoftimin e vendimeve, menaxhimin e ngarkesës dhe vlerësimet e cilësisë. Kur ka qenë e mundur, këto detyra janë kryer në distancë me ndihmë të teknologjive dixhitale, siç janë videokonferencat. Aranzhimet e brendshme të punës në administratat e shkallës së parë dhe të dytë janë rregulluar me qëllim për të minimizuar ndërprerjen e shërbimeve, duke iu përmbajtur njëkohësisht masave të shëndetit publik. Si pasojë, afatet procedurale janë zgjatuar në përputhje me rrethanat.

Formati për sigurimin e informacionit ka kaluar në seanca grupe të vogla, seanca nëpërmjet telefonit ose në internet dhe tutoriale video, ndërsa përpjekjet shtesë janë fokusuar sidomos në masat higjienike dhe protokollet e mbrojtjes që duhen ndjekur, si edhe në mbështetjen mjekësore dhe udhëzimet e nevojshme për të parandaluar ngjitjen. Ndiham juridike dhe përfaqësimi janë siguruar në distancë ose nëpër ndërveprime të kufizuara ballë për ballë. Si rezultat i drejtpërdrejtë i masave kufizuese të lidhura me COVID-19, janë raportuar kufizime në mundësitë e ndihmës juridike në kufij dhe në mjediset e pritjes dhe paraburgimit në disa vende. Duke marrë parasysh aftësitë e kufizuara për të kryer misione hetuese në vendet e origjinës, vendet e BE+ janë fokusuar në metoda të tjera për të mbledhur informacion nga vendi i origjinës (COI) dhe për të mbajtur kontakte me burimet e tyre.

Në fushën e pritjes, vendet e BE+ kanë përshtatur organizimin dhe infrastrukturën e pritjes në pajtim me rrethanat e pandemisë COVID-19, duke implementuar masa të tilla si një periudhë fillestare e karantinës pas mbërritjes, distancim fizik dhe lëvizshmëri të kufizuar nëpër mjediset e pritjes, kufizime lidhur me vizitat, si edhe masa higjienike dhe pajisje mbrojtëse shtesë. Kërkesat për hapësirë shtesë i kanë ngarkuar më tej autoritetet pritëse, menaxhmentin dhe stafin e pritjes, ndërsa shërbimet mbështetëse janë zvogëluar shpesh për të ruajtur distancën fizike ose kanë kaluar internet. Kjo ka pasur një ndikim veçanërisht të pafavorshëm në rast të aplikantëve me nevoja të veçanta, të cilët nganjëherë nuk kanë pasur në dispozicion të gjitha shërbimet mbështetëse të nevojshme. Në shumicën e vendeve të BE+, qendrat e paraburgimit kanë qenë më pak të zëna për shkak të kufizimeve lidhur me pandeminë COVID-19, duke marrë parasysh që dëbimi i aplikantëve të refuzuar është pezulluar dhe që shtetasit e shteteve të treta janë liruar.

Një nga fushat e prekura rëndë gjatë pandemisë janë mbrojtja dhe integrimi i përfituesve të mbrojtjes. Vonesat në zgjatjen e lejeve të qëndrimit për shkak të ndërprerjes së shërbimeve kanë çuar shpesh në pasiguri ligjore, duke penguar qasjen në të drejta të tjera, siç janë strehimi, punësimi dhe kujdesi shëndetësor. Procedurat e bashkimit familjar janë ndërprerë ose janë vonuar shumë dhe mundësitë e punësimit janë tkurrur. Mbështetja e duhur për shkollimin e fëmijëve nëpërmjet internetit ka qenë një sfidë e shpeshtë për shkak të mungesës së kompjuterëve, pamundësisë për t'u lidhur me internetin ose situatave të strehimit të pasigurt, ku nuk mund të sigurohet një mjedis i qetë për të mësuar. Programet mbështetëse dhe planet individuale të integritimit për përfituesit janë zgjeruar ose

përshtatur sipas rrethanave të reja. Sidoqoftë, pasojat e pandemisë mund të kenë efekte afatgjata për integrimin, nga shëndetësia deri në akomodimin dhe mundësitë e punësimit.

Kufizimet e udhëtimit kanë ndikuar sigurisht në zbatimin e kthimeve. Numri i kthimeve të detyruara ka rënë në mënyrë të ndjeshme, ndërsa kthimet vullnetare kanë vazhduar me zbatimin e protokolleve shëndetësore dhe masave paraprake të nevojshme. Shumë vende kanë pezulluar jo vetëm procedurat e kthimit por edhe lëshimin e vendimeve të kthimit, duke e zgjatur kështu periudhën e largimit vullnetar.

Në përgjithësi, vendet e BE+ kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve, duke demonstruar qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e sistemeve kombëtare të azilit dhe pritjes përballë situatave të papritura. Paralelisht, autoritetet gjyqësore kanë rishikuar masat e reja për t'u siguruar që ato t'u përmbaheshin standardeve dhe garancive ligjore.



Dixhitalizimi

Pandemia COVID-19 ka dhënë një shtysë të re për të vazhduar ose përshpejtuar përdorimin e teknologjive dixhitale në fushën e azilit. Në vitin 2020, vendet e BE+ kanë zhvilluar dhe zbatuar sisteme elektronike të reja përgjatë fazave të procedurës së azilit. Zgjidhjet dixhitale janë përdorur për regjistrimin e aplikacioneve në internet; verifikimin e identitetit të aplikantëve; paraqitjen e dokumenteve; intervistimin në distancë; ofrimin e informacionit, ndihmës juridike dhe shërbimeve të interpretimit; kryerjen e analizave gjuhësore; njoftimin e vendimeve dhe informacionit mbi statusin e çështjeve; paraqitjen e ankesave dhe nënshkrimeve dixhitale me qëllim për të mundësuar nxjerrjen e vendimeve; dhe sigurimin e mbështetjes për integrim, duke përfshirë mësimin e gjuhës, orientimin social dhe trajnimin për punësim. Një numër vendesh kanë përmirësuar gjithashtu sistemet e tyre elektronike për menaxhimin e pritjes, si edhe infrastrukturën e tyre IT, duke investuar në më shumë pajisje IT në ambientet e pritjes.

Sa i përket fushës së kthimit, vendet e BE+ kanë përvetësuar procedura në distancë për të siguruar komunikimin dhe këshillimin për riintegrim, ndërsa mjetet në internet kanë lehtësuar komunikimin me vendet e treta lidhur me procedurat e identifikimit të të kthyerve dhe lëshimin e dokumenteve të udhëtimit. Teknologjitë dixhitale janë përdorur gjithashtu në kontekstin e rivendosjes, duke përfshirë intervistat në distancë dhe orientimin virtual para largimit, në një përpjekje për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve.

Megjithëse dixhitalizimi ka shumë përfitime, vëmendja është tërhequr edhe ndaj rreziqeve të mundshme, duke përfshirë pëlqimin për përdorimin e të dhënave personale; çështjet e qasjes në profile të caktuara të aplikantëve, të cilët mund të mos kenë aftësi të edukimit dixhital ose mund të mos kenë as qasje në pajisje as lidhshmëri ose mund t'u mungojë ndërveprimi njerëzor për ofrimin e shërbimeve (për shembull për furnizimin e individëve me nevoja të veçanta me ushqim); si edhe ndaj rritjes së besimit midis grupeve të synuara me qëllim për të inkurajuar përdorimin e shërbimeve. Ndërsa puna drejt dixhitalizimit përparon, këto shqetësime duhet të merren në konsideratë dhe të adresohen në pajtim me rrethanat.





4.1 Hyrja në territor dhe procedura e azilit

Direktiva e rishikuar e Procedurave të Azilit ofron udhëzime vendeve të BE-së për t'u siguruar njerëzve në nevojë një qasje efektive në procedurë dhe për të mbrojtur të drejtën e tyre për të kërkuar mbrojtje. Gjatë vitit 2020, një numër incidentesh janë raportuar në kufijtë e jashtëm të BE-së lidhur me parandalimin ose vonesën e zbatimit të Direktivës së Reformuar të Procedurave të Azilit dhe, rrjedhimisht, me sigurimin e një qasjeje efektive në procedurën e azilit.

Zhvillimet kryesore legjislative dhe të politikave lidhur me qasjen në procedurën e azilit në vitin 2020 kanë vazhduar në të njëjtën rrugë si në vitet e mëparshme. Procedurat kanë vazhduar të adaptohen me qëllim që autoritetet të marrin sa më shumë informacion në fillim të procesit të azilit në mënyrë efikase dhe të koordinuar ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Qëllimi kryesor ka qenë kanalizimi më i mirë i rasteve nëpërmjet sistemit dhe përsheptimi i procesit të përgjithshëm.


Në vitin 2020, afërsisht 485.000 aplikime për mbrojtje ndërkombëtare janë nënshtruar në vendet e BE+, me një rënie të ndjeshme prej 32% në krahasim me numrin e aplikimeve në 2019. Rënia, e cila ka rezultuar në numrin më të ulët të aplikimeve vjetore që nga viti 2013, mund t'u atribuohet kufizimeve lidhur me pandeminë COVID-19 të cilat janë zbatuar në BE+ dhe vende të treta dhe kanë çuar në kufizimin lëvizjes brenda dhe jashtë vendit.

Faktikisht, numri i aplikimeve për azil është luhatur në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit. Numri i tyre ka vazhduar të rritet në fillim të vitit, me më shumë aplikime të nënshtruara në janar dhe shkurt 2020 sesa në të njëjtët muaj në 2019 (me një rritje prej 15% përkatësisht 10%). Sidoqoftë, pas shpërthimit të parë të COVID-19 në mars 2020, aplikimet kanë rënë ndjeshëm. Kur masat e izolimit janë hequr gradualisht në të gjitha vendet, ritmi i nënshtrimit të aplikimeve ka filluar të rritet përsëri (shihni Figurën 1).

Ndikimi i masave COVID-19 në aplikimet për azil është shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në të gjitha vendet e BE+. Në vendet ku procedura e azilit është pezulluar gjatë valës së parë të pandemisë, është vërejtur një rënie të dukshme në numrin e aplikimeve për azil, ndërsa vendet që e kanë mbajtur procedurën e azilit të hapur kanë pasur një ulje më të vogla.

Në përgjithësi, pothuajse dy të tretat (63%) të të gjitha aplikimeve për azil në vitin 2020 janë paraqitur në vetëm tri vende: Gjermania (122.000), Franca (93.000) dhe Spanja (89.000), pasuar në njëfarë distance nga Greqia (41.000) dhe Italia (27.000). Vendet kryesore të origjinës ishin të njëjtat që nga viti 2019: Siria (70.000), Afganistani (50.000), Venezuela (31.000), Kolumbia (30.000) dhe Iraku (20.000) - të gjitha me më pak aplikime në 2020. Së bashku, pesë kombësitë kryesore përbënin mbi dy të pestat e të gjitha aplikimeve në vendet e BE+.

Figura 1: Aplikimet për azil nga vendet me nivelet më të larta të pranimi, sipas muajit, 2019-2020



Burimi: Eurostat [[migr_asyappctzm](#)] më 28 prill 2021.



4.2 Procedura e Dublinit

Rregullorja e Dublinit III synon të përcaktojë një metodë të qartë dhe të realizueshme për të përcaktuar se cili Shtet Anëtar është përgjegjës për ekzaminimin e secilës kërkesë për azil. Objektivi i saj është të garantojë që aplikuesit të kenë akses efektiv në procedurat për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare dhe që ekzaminimi i një aplikimi të kryhet nga një Shtet Anëtar i vetëm dhe i përcaktuar qartë. Sistemi i Dublinit ka qenë një nga aspektet më të diskutuara të CEAS, sidomos lidhur me balancimin e ndarjes së përgjegjësisë dhe solidaritetin midis Shteteve Anëtare.

E ardhmja e mundshme e procedurës së Dublinit është theksuar në vitin 2020 me prezantimin e [Paktit të ri të Komisionit Evropian për Migracionin dhe Azilin](#) dhe [Propozimit për Rregulloren mbi Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit](#). Pakti synon të zëvendësojë sistemin e Dublinit me një kornizë të përbashkët, e cila do të përfshijë, përveç mekanizmave efektivë për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për çdo aplikim azili, edhe një mekanizëm gjithëpërfshirës të ri të solidaritet të vazhdueshëm mbi bazën e kriterëve të efektshme.

Në bazë të të dhënave të shkëmbyera nëpërmjet Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Gatishmërisë (EPS) të EASO-së, 95.000 vendime janë lëshuar në vitin 2020 si përgjigje ndaj kërkesave të Dublinit. Kjo përfaqëson një rënie për një të tretë në krahasim me vitin 2019 dhe është në përputhje me shkallën e uljes së numrit të aplikimeve për azil të paraqitura në vitin 2020. Në të vërtetë, raporti i vendimeve të Dublinit që janë pranuar lidhur me aplikimet e paraqitura për azil ka qenë prej 20%, dmth. ishte i ngjashëm me raportin prej 2019.

Në nivel të vendeve, Franca dhe Gjermania kanë vazhduar të marrin numrin më të marrë të vendimeve, me të cilat kërkohet që një shtet tjetër të marrë përsipër përgjegjësinë, duke përfaqësuar së bashku mbi tri të pestat të totalit në BE+. Niveli i përgjithshëm e pranimi për vendimet mbi kërkesat e Dublinit në vitin 2020, i matur si përqindja e vendimeve për të pranuar përgjegjësi nga të gjitha vendimet e lëshuara, ishte 56%, duke treguar një rënie të vazhdueshme për vitin e tretë radhazi në

nivelin e BE+ dhe në shumicën e Shteteve Anëtare të Dublinit. Sidoqoftë, kishte ndryshime të mëdha në nivelet e pranimit në nivel të vendit.

Midis zhvillimeve të tjera të rëndësishme në nivel evropian, klauzola diskrecionale në Rregulloren e Dublinit III, neni 17 (2) ka qenë baza e skemës së rivendosjes për 1.600 fëmijë të pashoqëruar, si edhe fëmijë me kushte mjekësore të rënda dhe cenusshmëri të tjera së bashku me familjet e tyre, nga Greqia në Shtetet Anëtare të tjera. Klauzola është përdorur gjithashtu për rivendosje të vazhdueshme pas zbarkimeve nga operacionet e kërkimit dhe shpëtimit në Itali dhe Maltë.

Neni 17 (1) i Rregullores së Dublinit, një klauzolë tjetër diskrecionale, është zbatuar pak më shumë se 4.700 herë në 2020, duke treguar një rënie të ndjeshme për gati një të tretë në krahasim me 2019. Sipas kësaj klauzole, një Shtet Anëtar mund të vendosë të ekzaminojë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, edhe nëse nuk është përgjegjësia e tij sipas kritereve në Rregulloren e Dublinit III. Në vitin 2020, arsyet për të vepruar kështu përfshinin numrin e rasteve të COVID-19 në një vend të caktuar.

Natyrisht, masat pandemike dhe emergjente lidhur me COVID-19 të zbatuara nga vendet e BE+ kanë vështirësuar transferimet e Dublinit. Në përgjithësi, rreth 13.600 transferime janë kryer dhe kjo përfaqëson një gjysmë të numrit të transferimeve në 2019. Numri është zvogëluar në mars 2020 dhe pastaj ka rënë në nivele edhe më të ulëta nga prilli deri në qershor 2020. Që nga korriku i vitit 2020, implementimi i transferimeve ka filluar të rritet gradualisht, por numri mujor i transferimeve nuk është kthyer në nivelet para pandemisë COVID-19 më vonë gjatë vitit. Katër vende - Franca, Gjermania, Greqia dhe Holanda kanë implementuar mbi tri të katërtat e të gjitha transferimeve.

Gjykatat kombëtare kanë marrë shumë ankesa lidhur me modalitetet dhe afatet e transferimit. Shumë prej këtyre ankesave kishin të bënin me llogaritjen e afateve të transferimit në kontekstin e pandemisë COVID-19.



4.3 Procedurat speciale

Gjatë ekzaminimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare në shkallën e parë, në kushte të caktuara, Shtetet Anëtare mund të përdorin procedura speciale, si p.sh. procedurat e përshpejtuara ose procedurat me prioritet, duke iu përmbajtur njëkohësisht parimeve bazë dhe garancive të përcaktuara në legjislacionin evropian të azilit. Lloje të ndryshme të procedurave kufitare janë implementuar ose zgjeruar në vitin 2020, zakonisht duke u fokusuar në përpunimin e shpejtë. Disa shtete anëtare kanë ngritur shqetësime lidhur me gjendjen e akomodimit në kufi, duke marrë masa paraburgimi dhe duke mbrojtur garancitë për aplikantët me nevoja të veçanta.

Vendet e BE+ janë fokusuar në rishikimin periodik të listave të veta të vendeve të sigurta të origjinës, duke rezultuar në disa ndryshime në këto lista në vitin 2020. Listat shërbejnë si informacion bazë mbi aplikimet e azilit që zgjidhen në procedurë të përshpejtuar dhe trendi i vërejtur në të gjitha vendet e BE+ në vitin 2020 ka qenë përparësia e çështjeve të përpunuara sipas procedurës së përshpejtuar gjatë fazës së parë të pandemisë COVID-19.

Nëpërmjet ndryshimeve legjislative dhe të politikave, shumë vende BE+ gjithashtu janë fokusuar në përcaktimin e kritereve për aplikimet vijuese për mbrojtje ndërkombëtare për të parandaluar keqpërdorimin e sistemit të azilit duke depozituar aplikime të përsëritura pa meritë. Në përgjithësi, në vitin 2020 vendet e BE+ kanë marrë rreth 56,000 aplikime të përsëritura, që përfaqëson një rënie prej 19% në numrat absolutë në krahasim me 2019 por një rritje prej 2% në pjesën e aplikimeve të përsëritura brenda numrit të përgjithshëm të aplikimeve.



4.4 Përpunimi i aplikimeve për azil në shkallë të parë

Përpjekjet në vitin 2020 janë fokusuar në përpunimin e shpejtë dhe efikas duke ofruar garanci njëkohësisht për aplikantët në vendet e BE+. Rënia e aplikimeve për azil në vitin 2020 ka ofruar mundësi për të rishikuar praktikat aktuale; për të implementuar metoda më efikase, duke përfshirë dixhitalizimin; për të nxjerrë udhëzime të reja lidhur me vlerësimin e aplikimeve dhe për të zgjidhur çështjet në pritje.

Në kombinim me uljen e konsiderueshme në numrin e aplikimeve të paraqitura, ndryshime të tilla kanë kontribuar ndoshta në numrin e vendimeve të lëshuara në vendet e BE+, duke tejkaluar numrin e aplikimeve të paraqitura për herë të parë që nga viti 2017. Në përgjithësi, autoritetet në fushën e azilit në vendet e BE+ kanë lëshuar rreth 534.500 vendime të shkallës së parë në vitin 2020 dhe vetëm pesë vende kanë lëshuar më shumë se katër të pestat e të gjitha vendimeve të shkallës së parë: Gjermania (24%), Spanja (23%), Franca (16%), Greqia (12%) dhe Italia (8%). Shumica e vendimeve të shkallës së parë u janë lëshuar shtetasve të Sirisë, Venezuelës, Afganistanit dhe Kolumbisë (sipas rendit zbritës).

Përveç kësaj, rreth 47.200 aplikime janë tërhequr, numri më i ulët që nga viti 2013 dhe mbi një e katërta më pak sesa në 2019. Rënia si në numrin e aplikimeve ashtuedhe në numrin e aplikimeve të tërhequra ka rezultuar në një raport prej 1 tërheqjeje për çdo 10 aplikime të paraqitura në vitin 2020, një nivel i ngjashëm me atë të vitit 2019. Ndërsa të dhënat e Eurostat-it nuk tregojnë llojin e tërheqjes, të dhënat e EPS sugjerojnë që shumica e aplikimeve të tërhequra në vitin 2020 janë tërhequr në mënyrë implicite, si në vitet e mëparshme. Tërheqjet, veçanërisht ato të padyshimta, mund të shërbejnë si tregues të largimit dhe të fillimit të lëvizjeve dytësore drejt vendeve të tjera BE+. Në përputhje me këtë interpretim, shumica e tërheqjeve u zhvilluan në Shtetet Anëtare të vijës së frontit, si p.sh. Greqia dhe Italia, që së bashku kishin më shumë se një të tretën e të gjitha tërheqjeve.



4.5 Përpunimi i aplikimeve për azil në shkallën e dytë dhe shkallët më të larta

Ndërsa vëllimi i vendimeve për aplikimet në shkallën e parë ka mbetur relativisht i qëndrueshëm në vitin 2020, numri i vendimeve të lëshuara në shkallën e dytë ose në shkallët më të larta është ulur për gati një të pestë: nga rreth 300.000 në 2018 dhe 2019 deri në rreth 237.000 në 2020. Në mënyrë të ngjashme me vitet e mëparshme, tri vende të BE+ përbënin më shumë se dy të tretat e të gjitha vendimeve të lëshuara në apeline ose rishqyrtime: Gjermania (42% e vendimeve totale në shkallën e dytë ose në shkallët më të larta), Franca (18%) dhe Italia (10%). Në vitin 2020, më shumë se dy nga çdo pesë vendime në shkallën e dytë ose në shkallët më të larta u janë dhënë afganëve, iranianëve, pakistanezëve, sirianëve dhe nigerianëve, e njëjta situatë e vërejtur në 2019.

Ndryshimet legjislative dhe të politikave në shkallën e dytë në vendet e BE+ fokusohen në riorganizimin e organeve të shkallës së dytë me qëllim për të rritur specializimin; pezullimin e kthimit gjatë një ankese; si edhe në përshtatjen e përkohshme të procedurave me shkrim dhe me gojë dhe të afateve kohore lidhur me kufizimet e imponuara nga pandemia COVID-19.



4.6 Çështjet në pritje

Duke marrë parasysh se numri i vendimeve të lëshuara tejkalon numrin e aplikimeve të paraqitura në 2020, numri i çështjeve në pritje ka rënë në vendet e BE+. Rreth 773.600 aplikime për azil prisnin një vendim në fund të vitit 2020, duke përfaqësuar një rënie prej 18% në krahasim me 2019. Megjithatë, numri i çështjeve në pritje ishte akoma më i lartë sesa para krizës në 2014.



4.7 Pritja e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare

Në vitin 2020, tendencat e identifikuar në vitet e mëparshme kanë vazhduar dhe disa vende kanë nisur reforma të rëndësishme në sistemin e tyre të pritjes, duke përfshirë riorganizimin institucional dhe rregullimin e kapacitetit të pritjes. Centralizimi dhe koordinimi i shtuar i fazës fillestare të pritjes ka vazhduar dhe më shumë vende kanë përparuar drejt krijimit të qendrave të mbërritjes, duke mbledhur të gjithë palët e interesit të procesit të azilit dhe pritjes në një vend me qëllim për të lehtësuar hapat fillestarë të procedurës.

Fenomeni i përfituesve të njohur të mbrojtjes ndërkombëtare ose i ish-aplikantëve që qëndrojnë në strukturat e pritjes edhe pas përfundimit të procedurës së azilit ka vazhduar në disa shtete anëtare të BE-së. Në vitet e mëparshme, fokusimi ishte te përfshirja e shpejtë e aplikantëve në trajnime, si edhe në vlerësimin dhe zhvillimin e aftësive të lidhura me punësimin. Ndërsa kjo dukej të ishte parimi udhëzues kryesor i Shteteve Anëtare, zvogëlimi i shërbimeve - duke përfshirë arsimin dhe trajnimin - për shkak të pandemisë COVID-19 ka çuar në rrezik që këto programe të jenë më pak efektive, me gjithë përpjekjet e autoriteteve kombëtare.

Disa nga shqetësimet lidhur me kushtet e ambienteve të pritjes të shprehura nga UNHCR dhe organizatat e shoqërisë civile në shtete dhe situata specifike, për shembull në hotspot-e, duket se janë intensifikuar gjatë vitit. Ngjarjet tragjike në kampin Moria në Lesvos kanë mundësuar një bashkëpunim të ri dhe të shumëanshëm për të përmirësuar kushtet e pritjes.



4.8 Paraburgimi gjatë procedurës së azilit

Në vitin 2020, një numër vendesh të BE+ kanë ndryshuar legjislacionin e vet lidhur me paraburgimin në kontekstin e ardhjes masive të shtetasve nga vende të treta dhe procedurave të kthimit. Është vërejtur një përpjekje në disa vende për të modifikuar politikat në drejtim të alternativave për paraburgimin, ndërsa në vendet e tjera alternativa të tilla kanë mbetur të kufizuara. Sfidat kryesore kanë vazhduar të justifikojnë paraburgimin, kushtet e paraburgimit dhe vendosjen e të miturve në paraburgim, ndërsa alternativat kanë mbetur të kufizuara. Gjatë vitit, gjykatat në nivel evropian dhe kombëtar kanë qenë aktive në analizimin e politikave dhe praktikave të paraburgimit, në interpretimin e ligjit në praktikë dhe në vendosjen e standardeve.



4.9 Akses në informacion

Vendet e BE+ kanë përforcuar dhe adaptuar praktikën e veta për të siguruar që aplikantët e azilit të kenë qasje efektive në informacion dhe korrektësi procedurale. Përpjekjet e fokusuar në përdorimin e teknologjive të reja; vendosja e kanaleve alternative për

shpërndarjen e informacionit dhe ngritja e vetëdijes nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, të tilla si platformat dhe hub-et, aplikacionet mobile dhe kanalet e mediave sociale. Shumë vende kanë zhvilluar linja telefonike të dedikuara dhe kanë riorganizuar faqet ekzistuese të internetit për të siguruar që informacioni të jetë i disponueshëm në shumë gjuhë. Informacioni i vënë në dispozicion përfshin aspekte të procedurës së azilit, jetës së përditshme në vendin pritës, integritit dhe kthimit, si edhe azhurnime mbi masat e lidhura me COVID-19.



4.10 Asistenca dhe përfaqësimi ligjor

Me qëllim për të zbutur masat kufizuese COVID-19 dhe për të vazhduar qasjen në ndihmën ligjore, shumë vende kanë organizuar seanca informimi mbi ndihmën juridike në nivel individual, në grupe më të vogla ose duke zëvendësuar ndërveprimin ballë për ballë me telefonata dhe video-thirrje. Një numër vendesh kanë miratuar gjithashtu legjislacionin ose politikën e reja për qasjen në ndihmën ligjore dhe përfaqësimin gjyqësor dhe disa prej tyre kanë ofruar për herë të parë qasje në ndihmën ligjore dhe përfaqësimin gjyqësor edhe në shkallën e parë.

Projektet ekzistuese janë zgjeruar dhe bashkëpunimi me palët e tjera të interesit është përforcuar. Janë implementuar edhe masa për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve duke rritur normën për orë për avokatët dhe duke rritur gjithashtu kërkesat e kualifikimit. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile kanë ngritur shqetësime gjatë vitit 2020 lidhur me qasjen e penguar ose të pamjaftueshme në ndihmë ligjore dhe përfaqësim gjyqësor - pjesërisht për shkak të kufizimeve të imponuara nga COVID-19 - në kufi, në qendrat e paraburgimit dhe në ambientet e pritjes.



4.11 Shërbimet e interpretimit

Fokusi i vitit 2020 ka qenë të rritja e standardeve të kualitetit për shërbimet e interpretimit, për shembull duke i trajnuar përkthyesit dhe duke përmirësuar mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Në rastet kur shërbimet e interpretimit janë prokuruar, kërkesa të reja janë shtuar në kontrata për të siguruar standarde më të larta. Është vërejtur nevoja për të përmirësuar shërbimet e interpretimit në kufij, si edhe mungesa e përkthyesve për gjuhë të caktuara në disa vende të BE+.



4.12 Informacioni nga vendi i origjinës

Në vitin 2020, vendet e BE+ kanë vazhduar përpjekjet e veta për të përmirësuar si gamën ashtu edhe cilësinë e informacionit për vendin e origjinës (COI). Duke marrë parasysh pamundësinë për të dërguar misione për gjetjen e fakteve, vendet janë fokusuar te metoda të tjera për të mbledhur informacione, ndërsa disa njësi të COI kanë përfutur nga masat e izolimit për të kryer një punë të thelluar, për të përmirësuar dhe azhurnuar informacionin në dispozicion dhe për të mbuluar një gamë më të gjerë temash.

Vendet me administrata më të vogla për çështjet e azilit kanë ndërmarrë hapa drejt krijimit të njësie COI ose të një metodologjie për t'i ngarkuar punonjësit përgjegjës me vende të caktuara të origjinës, duke mundësuar në këtë mënyrë ofrimin e rregullt të azhurnimeve. Hulumtimi dhe raportimi janë fokusuar në azhurnimin e informacionit mbi vendet për të cilat COI ishte tashmë në dispozicion, kryesisht mbi vendet më të zakonshme të origjinës së azilkërkuesve, të tilla si Afganistani, Irani, Iraku dhe Siria, por gjithashtu janë bërë përpjekje për të mbledhur informacione mbi vendet më pak të

zakonshme të origjinës për të cilën ekzistonte COI i kufizuar ose fare, për shembull Kolumbia dhe Sri Lanka.



4.13 Mungesa në kontekstin e azilit

Personat pa nënshtetësi dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare janë dy kategori të ndryshme në ligjin ndërkombëtar, por një person mund të jetë përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare dhe pa nënshtetësi. Në kontekstin e azilit, mungesa e nënshtetësisë mund të ndikojë në procesin e përcaktimit për një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, si edhe mbrojtjet procedurale. Një numër vendesh BE+ morën hapa për adresimin e mungesës së nënshtetësisë gjatë vitit 2020, duke përfshirë anëtarësimin në instrumentet përkatëse ligjore ndërkombëtare, krijimin e procedurave të dedikuara për përcaktimin e mungesës së nënshtetësisë, ofrimin e aksesit në nënshtetësi në lindje, lehtësimin e aksesit në natyralizim, përshejtimin e procesit të përcaktimit të mungesës së nënshtetësisë dhe sigurimin e mbledhjes së të dhënave të regjistrimit për personat pa nënshtetësi.

Megjithatë, duket se vazhdojnë sfidat me të cilat përballen personat pa shtetësi në faza të ndryshme të procedurës së azilit, duke përfshirë mungesën e vetëdijes për çështjet që lidhen me pashtetësinë në procedurën e azilit, mungesën e proceseve për përcaktimin e pashtetësisë në disa vende të BE+, si edhe rritjen e rrezikut të arbitraritetit dhe paraburgimit të personave pa shtetësi për arsye migracioni.




4.14 Përmbajtja e mbrojtjes

Personave që kanë marrë një vendim pozitiv u akordohet një formë mbrojtjeje në vendet e BE+, e cila përfshin një sërë të drejtash dhe detyrimesh, si edhe qasjen në një numër shërbimesh. Një vendim pozitiv është një vendim, më të cilin jepet statusi i refugjatit, mbrojtje subsidiare (të dyja janë të rregulluara nga ligjet e BE-së) ose mbrojtje humanitare (e cila akordohet sipas ligjit kombëtar). Shkalla e njohjes i referohet numrit të vendimeve pozitive si përqindja e numrit të përgjithshëm të vendimeve lidhur me aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare.


Në vitin 2020, shkalla e njohjes BE+ për vendimet e shkallës së parë mbi aplikimet e azilit ka qenë 42%: dmth. nga 534.500 vendime të lëshuara, 224.000 kanë qenë pozitive dhe aplikantëve u është dhënë një formë mbrojtjeje. Shumica e vendimeve pozitive në shkallën e parë kanë dhënë statusin e refugjatit (113.000 ose një gjysmë e të gjitha vendimeve pozitive). Mbrojtja subsidiare është dhënë në afërsisht 52.000 raste (23% e të gjitha vendimeve pozitive), ndërsa statusi humanitar është dhënë në 59.000 raste (27% e të gjitha vendimeve pozitive) (shihni Figurën 2).

Figura 2. Rezultati i vendimeve lidhur me aplikimet e azilit në shkallën e parë, në shkallën e dytë ose në shkallë më të larta në vendet e BE+, 2020

A. Vendimet në shkallën e parë



B. Vendimet në shkallën e dytë ose shkallë më të larta



Burimi: Eurostat [[miqr_asyappctzm](#)] më 28 prill 2021.

Në shkallën e dytë shkallët më të larta, 237.000 vendimet e lëshuara në vendet e BE+ kanë përfshirë 70.000 vendime pozitive, duke rezultuar në një normë njohjeje prej 29%. Me vendimet pozitive në shkallën e dytë dhe shkallë më të larta është dhënë më së shpeshti statusi humanitar (26.000), ndërsa statusi i refugjatit dhe mbrojtja subsidiare janë dhënë më rrallë (22.000 për secilën kategori).

Shtirja dhe cilësia e të drejtave dhe shërbimeve që marrin përfituesit e mbrojtjes formësojnë perspektivat e tyre të integritimit në shoqëritë e reja. Në vitin 2020, disa vende kanë implementuar masa për të rregulluar situatën e grupeve specifike të të huajve. Disa vende kanë nisur ndryshime për të lehtësuar bashkimin familjar për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare dhe kanë ofruar sqarime lidhur me procesin përmes udhëzimeve më të hollësishme, ndërsa gjykatat kanë mbetur aktive në formësimin e politikave dhe praktikave të bashkimit familjar. Në të njëjtën kohë, tendencat e viteve të mëparshme kanë vazhduar të tregojnë një rritje në rishikimin e statusit, si edhe në përdorimin më rigoroz të ndërprerjes dhe revokimit.

Hartimi dhe nisja e Planit të ri të Veprimit të BE-së për Integritim dhe Përfshirje ka ofruar udhëzime të mëtejshme për strategjitë e integritimit në nivel kombëtar. Vendet e BE+ kanë vazhduar përpjekjet e tyre për t'i mbështetur përfituesit përmes mësimin të gjuhës, qasjes në arsim dhe aftësimin profesional, mundësive të punësimit dhe orientimit socio-kulturor, duke theksuar në kohën e fundit personalizimin e planeve të integritimit të përshtatura për nevojat individuale të përfituesve. Në vitet e fundit, përpjekjet janë intensifikuar për të vlerësuar planet e integritimit përmes hulumtimit ndërdisiplinor në mënyrë që të vlerësohet efekti i politikave ekzistuese dhe të ofrohen rekomandime për të ardhmen. Një fushë shqetësuese në vitin 2020 kanë qenë çrregullimet e shkaktuara nga pandemia COVID-19 në qasjen efektive në arsim për fëmijët refugjatë dhe një numër i caktuar palësh të interesuara kanë kërkuar mjete të shpejta për të shmangur pasoja afatgjata.

Një shqetësim i vazhdueshëm është situata e personave që u është dhënë mbrojtje ndërkombëtare në një Shtet Anëtar, por më pas kanë shpërngulur dhe aplikuar përsëri për azil në një shtet tjetër. Ngjarjet janë çdo herë e më të rëndësishme për disa Shtete Anëtare dhe janë theksuar në debatet politike lidhur me propozimet e reformës nga 2016 dhe Paktin për Migracion dhe Azil.



4.15 Kthimi i ish-aplikuesve

Ndërsa shkalla e kthimeve të shtetasve të vendeve të treta ka mbetur relativisht e ulët në shumë vende të BE+, një numër iniciativash të reja legjislative dhe politike janë miratuar në vitin 2020 me qëllim për të përmirësuar zbatimin e kthimeve dhe efektivitetin e kostos së procesit të kthimit. Disa vende kanë implementuar rregulla më të rrepta lidhur me detyrimin për të bashkëpunuar, identifikimin e personave që do të kthehen dhe afatet kohore për njoftimin e largimeve.

Vendet kanë promovuar gjithashtu kthimet vullnetare dhe ndihmën e ofruar me këtë qëllim, duke përmirësuar bashkëpunimin me Fronteks-in. Shumë zhvillime kishin të bënin me zbatimin e kthimeve duke marrë parasysh parimin e *non-refoulement* dhe aspektet humanitare, duke përfshirë kthimin dinjitoz të të miturve të pashoqëruar.



4.16 Rivendosja dhe pranimet humanitare

Rivendosja dhe pranimet humanitare luajnë një rol kyç në ofrimin e rrugëve ligjore dhe të sigurta për mbrojtjen e njerëzve në nevojë. Që nga prezantimi i Skemës së parë Evropiane të Rivendosjes në korrik 2015, procesi ka mbetur në një pozitë të lartë në axhendën e politikave. Për shkak të kufizimeve të lidhura me COVID-19, numri i refugjatëve efektivisht të rivendosur në vendet e BE+ gjatë vitit 2020 është zvogëluar në mënyrë të pashmangshme.

Në përputhje me udhëzimet e Komisionit Evropian për zbatimin e dispozitave përkatëse të BE-së në fushën e azilit, procedurës së kthimit dhe rivendosjes, vendet e BE+ kanë përshtatur modalitetet e veta për të siguruar, kur është e mundur, vazhdimësinë e proceseve të rivendosjes, për shembull duke përpunuar raste urgjente në bazë dosjeje dhe duke bërë intervista në distancë. Deri në fund të vitit 2020, shumica e vendeve nuk i kishin përmbushur kuotat kombëtare dhe kanë qenë në detyrë të kërkojnë transferime për vitin vijues, duke shprehur angazhimin e tyre për të ofruar rrugë të sigurta të mbrojtjes.



Fokusimi tek azilkërkuesit me cënueshmëri

Në 2020 rreth **14.200** aplikime për mbrojtje ndërkombëtare u depozituan nga **të mitur të pashoqëruar** në vendet BE+,



duke përfaqësuar **3%** të numrit total **485.000** të aplikimeve të azilit në 2020

Pothuajse **9** nga **10** të mitur të pashoqëruar që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare ishin djem



41% e të miturve të pashoqëruar vijnë nga **Afganistani**

Shumë përpjekje janë të nevojshme për të mbrojtur **gratë dhe vajzat** në procedurën e azilit nga dhuna, trafikimi i qenieve njerëzore dhe FGM/C



Ka nevojë për masa mbrojtëse për të parandaluar që fëmijët në procedurën e azilit të bien në duart e **trafikantëve të qenieve njerëzore**



Personat LGBTI u nënshtrohen abuzimeve të të drejtave të njeriut në shumë vende të botës. Ata mund të kenë frikë të flasin hapur gjatë procedurës së azilit



Burim: EASO

5. Fëmijët dhe aplikantët me nevoja të veçanta

Legjislacioni i BE-së për azilin përfshin dispozita mbi identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për aplikuesit që kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale. Mes aplikuesve vulnerabël, një prej grupeve kyçe janë minorenët e pashoqëruar që kërkojnë mbrojtje pa kujdesin e një të rrituri përgjegjës. Pakti i ri për Migracion dhe Azil përfshin disa dispozita për të siguruar që interesat më të mirë të fëmijës të merren në konsideratë, për shembull duke përforcuar ribashkimin e familjes dhe duke nxitur një mekanizëm më të fortë solidariteti për rivendosjen e fëmijëve të pashoqëruar dhe aplikantëve me cënueshmëri.

Në 2020 rreth 14.200 aplikime për mbrojtje ndërkombëtare u depozituan nga të mitur të pashoqëruar në vendet BE+, duke përfaqësuar 3% të numrit total 485.000 të aplikimeve. Në krahasim me vitin 2019, numri absolut i të miturve të pashoqëruar ka mbetur relativisht i qëndrueshëm (-3%). Megjithatë, duke pasur parasysh uljen e fortë në numrin e përgjithshëm të aplikimeve për azil, kjo rezultoi në një rritje të përqindjes së të miturve të pashoqëruar nga viti 2019 për 1%.

Një pjesë e madhe e të miturve të pashoqëruar vijnë nga Afganistani, duke përfaqësuar 41% të aplikimeve nga të mitur në vendet e BE+ në vitin 2020 (rritje për 11% nga 2019), pasuar nga Siria, me 16% (rritje për 6%). Ashtu si në vitet e mëparshme, shumica dërrmuese e të miturve të pashoqëruar që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në vendet e BE+ ishin meshkuj (pothuajse 9 nga 10). Shumica e aplikantëve të mitur të pashoqëruar ishin në grupmoshën më të moshuar, me afërsisht dy të treta midis 16 dhe 17 vjeç, ndërsa vetëm një e dhjetë përafërsisht ishte më e re se 14 vjeç.

Duke theksuar rëndësinë e identifikimit dhe referimit të hershëm, një numër shtetesh të BE+ kanë azhurnuar legjislacionin, politikat dhe udhëzimet e veta në vitin 2020, duke zbatuar masa për monitorimin e cilësisë ose duke zhvilluar vlerësime të reja të cënueshmërisë për aplikantët me nevoja procedurale të veçanta. Ndryshime legjislative janë bërë për të përsheptuar emërimin e kujdestarëve ligjorë për të miturit e pashoqëruar. Megjithatë vërehen shpesh vonesa në emërimin e kujdestarëve pavarësisht nga këto përpjekje. Në përgjithësi, kufizimet në identifikimin efektiv dhe të shpejtë të aplikantëve të prekshëm, duke përfshirë të miturit, kanë mbetur një sfidë në vitin 2020, duke rritur rrezikun e paraburgimit ose vendosjes brenda ambienteve të pritjes që nuk i plotësojnë nevojat e tyre në mënyrë të duhur.

Në fushën e pritjes, autoritetet e vendeve të BE+ kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për të krijuar ambiente të specializuara me qëllim për t'u garantuar aplikantëve të prekshëm një vend të sigurt ku mund të adresohen nevojat e tyre të veçanta. Megjithatë, është raportuar shpesh se krijimi i një mjedisi fizikisht dhe psikologjikisht të sigurt me qasje në shërbime mbështetëse, duke përfshirë qasjen në arsim për të miturit, nuk është gjithmonë e mundur.

Kanë vazhduar përpjekjet për të mbrojtur gratë dhe vajzat në procedurën e azilit nga rreziqet, të tilla si dhuna në familje ose gjymtimi/prerja e organeve gjenitale të grave (FGM/C). Vendet e BE+ kanë ndërmarrë iniciativë të reja për të krijuar ambiente të sigurta për këtë profil aplikantësh dhe gjykatat kanë ndërhyrë për të mbrojtur gratë dhe vajzat që janë në rrezik të dhunës nëse kthehen në vendet e tyre të lindjes.

Një shqetësim i përbashkët lidhet me rritjen alarmante të trafikimit të të miturve dhe sidomos të migrantëve pa dokumente me fëmijë, të cilët përfaqësojnë pothuajse një të katërt të të gjitha viktimave. Rreziku është i veçantë serioz për gratë dhe fëmijët migrantë, jo vetëm gjatë rrugëve të rrezikshme të udhëtimit, por edhe pas arritjes së tyre në Evropë. Fëmijët mund të zhduken nga qendrat e pritjes dhe të bëhen viktimë të trafikantëve të genieve njerëzore.

Personat lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinjorë dhe ndërseksualë (LGBTI) u nënshtrohen abuzimeve të të drejtave të njeriut dhe përballen me kërcënime në shumë vende të botës. Ka nevojë

për një qasje e ndjeshme me këtë profil aplikantësh pasi ata mund të kenë frikë të flasin për orientimin e tyre seksual, identitetin dhe shprehjen gjinore, si edhe për karakteristikat e tyre seksuale (SOGIESC) gjatë procedurës së azilit. Zhvillimet në vitin 2020 janë fokusuar tek ofrimi i informacionit dhe caktimi i një vendi të sigurt për aplikantët me nevoja të veçanta lidhur me gjininë.



Sistemet e tanishme të azilit dhe pritjes në vendet e BE: Rruga përpara

Pavarësisht nga lëvizshmëria e zvogëluar në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, faktet tregojnë rrjedha të vazhdueshme migrimi

Investime të mëtejshme janë të nevojshme për të kaluar nga përgjigjet reaktive në zgjidhjet afatgjata

Dixhitalizimi ka potencial për të rritur efikasitetin dhe qasjen në procedurën e azilit



Gjykatat e BE-së dhe ato kombëtare luajnë një rol kyç në interpretimin e legjislacionit të BE-së në fushën e azilit, si edhe në ofrimin e udhëzimeve për zbatimin e tij praktik

Programet e rivendosjes dhe rrugët plotësuese janë thelbësore për sigurimin e një qasjeje të parashikueshme, të sigurt dhe të ligjshme në siguri në kontekstin e rrjedhave rritëse të migracionit



Udhëzimet dhe kontributet e EASO-së janë të nevojshme gjithnjë e më shumë me qëllim për të zhvilluar një sistem evropian të koordinuar



Pakti i Ri për Migracion dhe Azil propozon një kornizë gjithëpërfshirëse për të ofruar zgjidhje mbrojtëse në mënyrë të sigurt dhe të parashikueshme, duke akomoduar nevoja të ndryshme



Këto korniza të qëndrueshme nënkuptojnë përmirësimin e kushteve të pritjes, sigurimin e kujdesit shëndetësor në kohë dhe ofrimin e arsimit, si edhe përpjekje integrimi dhe procese dinjitoze për kthimin e shtetasve të vendeve të treta që nuk kanë nevojë për mbrojtje

Të drejtat themelore të njeriut dhe vlerat e BE-së duhet të shërbejnë si një busull për të udhëhequr rrugën përpara

Burimi: EASO



Vërejtjet përfundimtare: Rruga përpara



Ky është botimi i 10-të i *Raportit mbi Çështje Azili*, me të cilin EASO ka dokumentuar dhe analizuar progresin e qëndrueshëm që vendet e BE+ e kanë bërë në standardizimin dhe modernizimin e sistemeve të tyre të azilit dhe pritjes. Duke përdorur një përzierje të zgjidhjeve të përkohshme dhe të shpejta, si edhe të politikave përparimtare, vendet e BE+ kanë menaxhuar rrjedha migratore komplekse, duke adresuar njëkohësisht sfidat përgjatë rrugës. Në të vërtetë, urgjenca shëndetësore globale lidhur me pandeminë COVID-19 ka testuar sistemet e tanishme të azilit dhe pritjes, ndërsa zhvillimet e vërejtura në këtë raport kanë demonstruar qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e tyre për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve pavarësisht nga paraqitja e situatave të papritura. Është e qartë gjithashtu se nevoja për mbrojtje ndërkombëtare mbetet e dukshme, duke kërkuar zgjidhje që e nxisin qëndrueshmërinë afatgjatë.

Shfrytëzimi i përparimit të bërë deri më tani kërkon investime të mëtejshme në tranzicionin nga aranzhimet e përkohshme deri në një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative dhe politike, të dakorduar nga palët e interesit. Për këtë qëllim, bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe i përforcuar midis palëve të ndryshme të interesit është shumë e rëndësishme për të përfshirë ekspertizën dhe përparësitë krahasuese që secili mund të sjellë për zhvillimin e zgjidhjeve të përbashkëta. Gjatë këtij procesi të konsolidimit, të drejtat themelore të njeriut dhe vlerat e BE-së duhet të shërbejnë si një busull për të udhëhequr rrugën përpara.



Pavarësisht nga lëvizshmëria e zvogëluar në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, faktet tregojnë rrjedha të vazhdueshme migrimi

Pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të thellë dhe kompleks si në funksionimin e sistemeve të azilit dhe pritjes në vendet e BE+ ashtu edhe në numrin e njerëzve që kanë arritur në Evropë për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare. Numri i aplikimeve për azil të paraqitura në vendet e BE+ në vitin 2020 ka rënë në mënyrë të ndjeshme për një të tretë në krahasim me 2019, si pasojë e kufizimeve të udhëtimit dhe bllokimeve që kanë u penguar shumë njerëzve të udhëtojnë. Por nëse ekzaminojmë numrin e aplikimeve të paraqitura në janar dhe shkurt 2020 para implementimit të masave lidhur me COVID-19, do të vërejmë që është raportuar një rritje prej më shumë se 10% në krahasim me të njëjtët muaj në 2019, gjë që lë të kuptohet që trendi i mbërritjeve do të kishte rritur po të mos kishte ndodhur pandemia.

Duke marrë parasysh që epiqendrat e konfliktit, shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut, paqëndrueshmëria politike dhe vështirësitë ekonomike vazhdojnë të shkaktojnë zhvendosje të mëdha në tërë botën, duket se rrjedhat migratore në Evropë do të vazhdojnë me një ritëm të qëndrueshëm ose rritës. Ndërsa pandemia duket të jetë një faktor që e ka frenuar lëvizshmërinë në vitin 2020, kjo prirje mund të ndryshojë në të ardhmen. Nëse marrim parasysh kapacitetin e vendeve të ndryshme për të adresuar dhe kapërcyer efektet e ekonomike dhe sociale të pandemisë, rimëkëmbja pas COVID-19 mund të jetë e pabarabartë, do të ketë një efekt amplifikues në shkaqet para-ekzistuese të zhvendosjes dhe do të përkeqësojë çekuilibrat midis vendeve në zhvillim dhe vendeve më të zhvilluara. Kjo mund të katalizojë gjithashtu shpërnguljen nga vendet në zhvillim në vendet e zhvilluara. Në këtë kontekst, çështjet themelore në lidhje me kufijtë e jashtëm të BE-së do të mbeten një pjesë e rëndësishme e debatit publik, veçanërisht lidhur me hyrjen efektive në territor dhe procedurën e azilit, duke theksuar më tej nevojën për të kaluar në një kornizë të re, përbashkësisht të pranuar, për operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, zbarkimet, rivendosjet dhe ndarjen e drejtë të përgjegjësisë.

Roli i programeve të rivendosjes në sigurimin e qasjes së parashikueshme, të sigurt dhe të ligjshme në siguri do të jetë vendimtar përballë rrjedhave migratore rritëse. Pandemia COVID-19 ka pasur një efekt përçarës në proceset e rivendosjes në vitin 2020, gjë që thekson më tej rëndësinë e mbrojtjes së njerëzve nga udhëtimet e gjata dhe të rrezikshme në kërkim të sigurisë. Theksi i shtuar në rivendosje dhe rrugët plotësuese në Paktin e ri për Migracion dhe Azil është një tregues i fortë i angazhimit për të ofruar zgjidhje mbrojtëse në mënyrë të sigurt dhe të parashikueshme.



Pakti i ri për Migracion dhe Azil synon të akomodojë nevoja të ndryshme

Pakti i Komisionit Evropian për Migracion dhe Azil është propozuar në Shtator 2020 si një fillim i ri në forcimin e solidaritetit, duke adresuar sfidat e migracionit në mënyrë të harmonizuar dhe duke ndërtuar besim te sistemi i azilit të BE-së përmes procedurave më të shpejta dhe efektive. Konsultimi 12-mujor me aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë të ndryshëm para finalizimit të paktit të ri të propozuar ka qenë një hap pozitiv drejt shqyrtimit të perspektivave të ndryshme në ndërtimin e një arkitekture inkluzive dhe gjithëpërfshirëse të migracionit dhe azilit në Evropë. Negociatat mbi propozimet legjislative të përfshira në paktin e ri do të zënë një vend qendror në zhvillimet e ardhshme në fushën e migracionit dhe azilit.

Duke pranuar progresin e dukshëm të bërë deri tani, një numër pikash divergjence ende nuk janë adresuar. Vullneti politik, politikëbërja e frymëzuar dhe fleksibiliteti janë të nevojshëm për të arritur një përparim. Megjithatë nuk janë akoma në fuqi si akte legjislative, udhëzimet e dhëna në paktin e ri mund të ndikojnë tashmë në ndryshimet e politikave në disa vende, duke harmonizuar praktikën e tyre me ato që propozohen dhe duke nxitur bashkëpunimin praktik midis vendeve lidhur me çështjet e ngutshme, një trend që është vërejtur gjithashtu në propozimet vijuese të reformës CEAS 2016.



Me një sy te sistemet e qëndrueshme: Kalimi nga përgjigjet reaktive te zgjidhjet afatgjata

Duke ndërtuar mbi përvojat e së kaluarës, vendet e BE+ kanë vazhduar të adaptojnë legjislacionet, politikat, praktikën dhe rregullimet e veta organizative të përgjithshme në mënyrë që të menaxhojnë më mirë rrjedhat hyrëse të azilkërkuësve, të optimizojnë rrjedhat e punës, të rrisin efikasitetin dhe efektivitetin dhe të sigurojnë një proces dinjitoz të mbrojtjes. Një trend i zakonshëm në shumë vende të BE+ ka qenë rritja e centralizimit dhe koordinimit të fazës fillestare të azilit dhe pritjes, duke krijuar qendra mbërritjeje ku të gjithë palët e interesuara të procesit të azilit ndodhen në një vend. Qëllimi është të mbledhet sa më shumë informacion të jetë e mundur në fazën e hershme të procedurës me qëllim për të mundësuar një vendimmarrje efikase - një qasje që duket se është thelbësore edhe në paktin e ri. Duke përcaktuar shpejt se kush ka nevojë për mbrojtje dhe kush jo do të rritet integriteti i sistemeve të azilit. Diskutimet mbi këtë temë do të vazhdojnë me qëllim për të siguruar mekanizma që do të garantojnë respektimin e të drejtave themelore dhe sidomos të parimit *non-refoulement*.

Modifikime janë bërë gjithashtu brenda sistemeve të pritjes, sidomos për të siguruar shërbime të adaptuara për aplikantët me nevoja të veçanta. Përkundër këtyre përpjekjeve, kjo zonë nuk ka qenë e lirë nga sfida; ambientet e pritjes kanë qenë nganjëherë të mbingarkuara me kushte më pak sesa optimale, ndërsa qasja në shërbime, të tilla si arsimi dhe kujdesi shëndetësor, kanë vonuar ose kanë qenë të pamjaftueshme. Për shembull, të dhënat e disponueshme tregojnë se në vitin 2020 afërsisht 30% e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare në Evropë ishin fëmijë, shumë prej tyre në moshë shkollore. Shumë shpesh, këta fëmijë nuk kanë qasje të qëndrueshme dhe efektive në arsim. Edhe në rast të fëmijëve që kthehen në vendin e tyre pas një vendimi negativ, ofrimi i arsimit në fazën e pritjes është një vlerë më vete, e cila lehtëson rritjen e tyre në nivel konjitiv dhe social. Për ata që qëndrojnë,

mungesa e një qasjeje efektive në arsim mund të ketë efekte të dëmshme si në zhvillimin e tyre personal ashtu edhe në perspektivat e tyre të integritimit në plan afatgjatë. Fokusimi i menjëhershëm tek integrimi i përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare rezulton në përfitime të shumta lidhur me qëndrueshmërinë afatgjatë: pajimi i tyre me aftësitë e nevojshme për të përparuar në shoqërinë pritëse jo vetëm do të katalizojë kontributin e tyre pozitiv si anëtarë organikë të shoqërive të reja por gjithashtu do të rrisë kohezionin social të përgjithshëm.

Duke njohur funksionin e zgjidhjeve të përkohshme në mbulimin e nevojave të menjëhershme, kalimi drejt kornizave afatgjata dhe të qëndrueshme do të kërkojë përmirësime për të siguruar kushte cilësore të pritjes, sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe arsimit në kohë, fokusimin tek integrimi i përfituesve dhe procese dinjitoze për kthimin të shtetasve të vendeve të treta që nuk kanë nevojë për mbrojtje. Në këtë proces tranzitor, konceptet themelore të të drejtave të njeriut dhe parimet e BE-së mund të ofrojnë udhëzimet e nevojshme dhe të informojnë mbi zhvillimin dhe funksionimin e zgjidhjeve afatgjata të tilla.



Efikasitet i drejtë dhe drejtësia efikase: Gjykatat shqyrtojnë praktika të reja në përputhje me legjislacionin e BE-së për çështje azili

Institucionet gjyqësore në nivel kombëtar dhe të BE-së kanë vazhduar të pohojnë rolin e tyre në interpretimin e *acquis-it* të BE-së për çështje azili, duke udhëhequr zbatimin e tij praktik. Ky rol është theksuar në vitin 2020 kur gjykatat janë thirrur të vlerësojnë praktikën dhe masat e reja që ishin implementuar nga autoritetet kombëtare në një realitet të ri të drejtuar nga sfida të papara, i cili kërkonte përgjigje të shpejta dhe efikase. Gjykatat kombëtare kanë ndërhyrë për të vlerësuar ndikimin e masave të sigurisë COVID-19 në të drejtat e azilkërkuesve, si edhe ndërlikimet e transferimeve të Dublinit dhe afatet kohore lidhur me to. Gjithashtu Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian si autoriteti gjyqësor i BE-së ka nxjerrë një numër gjykimesh të rëndësishme, veçanërisht në lidhje me qasje efektive në procedurën e azilit.

Është e qartë se autoritetet gjyqësore do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e interpretimit dhe zbatimit korrekt të legjislacionit evropian në fushën e azilit, aq më tepër kur propozimet e Komisionit Evropian duhet të kalojnë në një kornizë legjislative dhe politike të dakorduar dhe duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të çështjeve që ende janë në pritje në shkallën e dytë.



Dixhitalizimi si katalizator për efikasitetin dhe aksesueshmërinë

Vendet e BE+ kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt implementimit të inovacioneve teknologjike me qëllim për të rritur automatizimin në procedurat e azilit. Pandemia COVID-19 ka siguruar një shtysë të re për vendet e BE+ për të rritur dixhitalizimin e proceseve, duke marrë parasysh se ato kanë pasur nevojë për të përshtatur modalitetet e tyre të punës për të zbutur rreziqet e urgjencës shëndetësore. Shumë prej këtyre zgjidhjeve ka të ngjarë të qëndrojnë në mënyrë të përhershme me qëllim për të rritur efikasitetin e sistemeve të azilit dhe pritjes, ndërsa zgjidhje të tjera mund të jenë pjesë e kutisë së mjeteve të vendeve të BE+ që do të përdoren përsëri në rast të sfidave të ngjashme në të ardhmen. Ndërsa puna drejt dixhitalizimit përparon, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë çështjeve të privatësisë së të dhënave, duke siguruar qasje të barabartë në shërbimet dixhitale dhe duke rritur besimin te zgjidhjet teknike të reja ndër aplikantët dhe përfituesit e mbrojtjes për të inkurajuar përdorimin e tyre.



Përgjigjja e koordinuar evropiane me EASO si pjesë përbërëse

Natyrë komplekse e azilit, e cila gjithashtu është e ndërthurur me çështjet e bashkimit familjar dhe kthimit, kërkon zgjidhje gjithëpërfshirëse. Në vitet vijuese, veprimi i koordinuar dhe integrimi i ekspertizës nga palë të ndryshme të interesit do të jenë thelbësore në zhvillimin e një qasjeje të ekuilibruar, ku pyetja kryesore do të jetë se si - dhe jo nëse - të gjithë palët e interesuara do të kontribuojnë. Standardizimi dhe zbatimi praktik i një sistemi funksional evropian të azilit do të kërkojë një vullnet të gjerë politik dhe një vizion të përbashkët; përgjigje të harmonizuara dhe të drejta ndaj presioneve migratore në vende të caktuara, duke respektuar të drejtat themelore të personave që kërkojnë mbrojtje; bashkëpunim të zgjeruar me vendet e origjinës dhe tranzitit; dhe përpjekje të vazhdueshme për të adresuar shkaqet themelore të migrimit të parregullt.

Në 10 vitet që nga themelimi i saj, EASO ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me Komisionin Evropian, Shtetet Anëtare, agjencitë evropiane, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare për të mbështetur zbatimin e CEAS në mënyrë holistike, duke përfshirë: ofrimin e ndihmës operacionale për Shtetet Anëtare që përjetojnë presion të lartë; ofrimin e trajnimit dhe mjeteve praktike me cilësi të lartë për profesionistët në fushën e azilit; kontribuimin në zbatimin e dimensionit të jashtëm të CEAS; dhe prodhimin e rezultateve analitike të besueshme për të informuar lidhur me vendimmarrjen. Gjatë këtyre viteve, EASO ka mbledhur një përvojë të gjerë dhe unike, ka zhvilluar metodologji inovative të punës, ka krijuar partneritete të forta dhe ka shërbyer si pjesë e zgjidhjes në avancimin e politikave dhe praktikave të orientuara drejt mbrojtjes.

Në një panoramë migratore globale në ndryshim të vazhdueshëm, udhëzimet dhe kontributet e EASO-së janë të nevojshme gjithnjë e më shumë. Si qendër ekspertize në fushën e azilit, mund të pritet që programi i punës së EASO do të rritet, veçanërisht përpara tranzicionit e saj te një Agjenci Azili të BE-së.



ISBN 978-92-9465-060-3